



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 39 Prot

Tiranë, më 11.01.2021

V E N D I M

Nr.8, datë 11.01.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ për verifikimin e ligjshmërisë të aktit nr. 12275, datë 1.7.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit *** dhe mënyrën e zbatimit të tij.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

Vërej se:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 661 prot., datë 7.8.2020, nëpunësi ***** , ka parashtruar pretendimin se, transferimi i përkohshëm në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Analizës/Ndërveprimit me Tatimet, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit”, pranë DPD, është bërë në shkelje të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, që rregullojnë institutin e transferimit të përkohshëm të nëpunësit civil.

Në kuadër të verifikimit të këtij pretendimi, pasi u shqyrtua dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit të hetimit administrativ, konstatohet se:

Pas ristrukturimit të kryer në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast, me aktin

nr. 561/17, datë 26.1.2018, ka miratuar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e përhershëm të nëpunësit *****, në pozicionin “Drejtor, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore”, në DPD dhe mbi këtë bazë, ka dalë akti nr. 2180, datë 26.1.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm. Procesi i ristrukturimit konsiderohet se është kryer në përputhje me rregullat që përcakton ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu siç referon pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Më pas, për nevoja të institucionit, me aktin nr. 9615, datë 15.4.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësi *****, është transferuar përkohësisht, në pozicionin “Drejtor, Drejtoria e Kontrollave Paszhdoganimit (Aposterior Operativ 5 ditor), Departamenti Operativ-Hetimor”, pranë DPD. Kërkuesi ka punuar në këtë pozicion deri kur me aktin nr.12275, datë 1.7.2020, ai është transferuar përsëri, në mënyrë të përkohëshme, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Analizës/Ndërveprimit me Tatimet, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit”, pranë DPD (ku vazhdon të punojë aktualisht), transferim i cili është kundërshtuar prej tij, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, sipas të drejtës që i jep pika 18, Kreu V, e VKM nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pasi ka marrë në shqyrtim rastin, ka kthyer përgjigje me shkrim, se transferimi është kryer në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kërkesave specifike të Kodit Doganor në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor. Përsa i përket transferimit të tij në një pozicion pune të kategorisë më të ulët, nga ana e institucionit, është arsyetuar se, ky transferim, është kryer si ndëshkim disiplinor ndaj tij, për shkak se, në cilësinë e eprorit të drejtpërdrejt, ai ka lejuar apo justifikuar shkeljen e konstatuar për një nëpunës vartës të tij (ndaj të cilit ka nisur procedura disiplinore).

Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të institucionit, punonjësi në fjalë ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, për tu kthyer në pozicionin e tij të punës si “Drejtor, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore”, në DPD, ku ai ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast, konstatohet që nga ana e organit publik, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, fillimisht janë mbajtur parasysh të gjitha dispozitat e legjisllacionit të shërbimit civil, të kombinuara me ato të legjisllacionit specifik doganor, ashtu siç përcaktohet në pikën 3, të nenit 13, të Kodit Doganor.

Konkretisht, transferimi i përkohshëm i nëpunësit *****, është bazuar në pikën 7, të nenit 15, të Kodit Doganor, i cili në shkronjën “a”, përcakton shprehimisht: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Siç shihet, në germën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, sipas së cilës mund të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj *(njëherësh ose e copëzuar)* për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Duke qenë se legjislacioni i posaçëm doganor, ka përparësi ndaj dispozitave të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, në rregullimin e marrëdhënieve të punësimit të punonjësve doganorë, dispozita e pikës 7, të nenit 15, të Kodit Doganor ka kuptimin që një nëpunës doganor, mund të transferohet përkohësisht për nevoja të institucionit, sa herë çmohet një nevojë e tillë, pa patur ndonjë kufizim në shpeshtësi, prandaj, në këtë vështrim nuk mund të merret parasysh pretendimi që transferimi i përkohshëm është i padrejtë për shkak se, është kryer në kushtet kur kërkuesi ka emërim definitiv pas ristrukturimit të institucionit.

Gjithashtu konstatohet që, aktet e transferimit të përkohshëm, janë të ligjshëm, pasi kanë dalë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, Kreu V, *“Transferimi i përkohshëm”*, e Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për personelin e administratës doganore”*, i ndryshuar dhe është ruajtur edhe kategoria e pagës që ka patur në pozicionin ku ka emërimin e përhershëm *(kategoria III-a)*.

Ndërkaq, nga verifikimi i mëtejshëm i këtij rasti rezulton se, pozicioni i punës ku është transferuar aktualisht nëpunësi në fjalë, *“Përgjegjës i Sektorit të Analizës/Ndërveprimit me Tatimet, Drejtorja e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit”*, në DPD, ka një kategori më të ulët se pozicioni i përhershëm i tij (kategori page III-a/1, sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur VKM nr. 2, datë 8.1.2018, *“Për disa ndryshime në Vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të*

ndryshuar”), por pavarësisht këtij fakti, ai paguhet me kategorinë e pagës III-a, që është e njëjtë me kategorinë e pagës së mëparshme.

Pra, në këtë rast, institucioni ka ruajtur kategorinë e pagës, por ka lejuar transferimin e përkohshëm në një pozicion me kategori më të ulët, me arsyetimin se, ky nëpunës, në cilësinë e eprorit direkt, ka lejuar apo justifikuar shkelje të konstatuara për një vartës të tij, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, duke i dhënë transferimit të përkohshëm formën e një ndëshkimi disiplinor.

Arsyetimi i institucionit në lidhje me këtë transferim, nuk është i bazuar në ligj, pasi ky lloj “*ndëshkimi*” nuk është i lejuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe në atë doganor. Nëse ky nëpunës, konsiderohet përgjegjës për shkeljen si më sipër, ndaj tij duhet të zbatohet procedura disiplinore e parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil dhe në Kodin Doganor si dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tyre, e cila i siguron nëpunësit civil mundësinë e shprehjes dhe mbrojtjes, e në përfundim të saj, nëse ai rezulton me faj, duhet të aplikohet një prej masave disiplinore të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, nëse nuk jemi në kushtet e një ecurie disiplinore, transferimi i përkohshëm duhet të kryhej sipas rregullave të përcaktuara në pikën 7, neni 15, të kodit doganor, ku në shkronjën “a” parashikohet: “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë...*”. Pra, pavarësisht faktit se është ruajtur kategoria e pagës (III-a), sipas kësaj dispozite, në raste të tilla duhet të mbahet parasysh që të ruhet edhe kategoria e pozicionit të punës, e cila në rastin konkret, në krahasim me pozicionin e mëparshëm të kërkuesit (“*Drejtor drejtorie*” që i përket nivelit të nëpunësisë kategoria A), është i një kategorie më të ulët, pasi pozicioni “*Përgjegjës sektori*” në DPD (*pozicioni aktual*), i përket nivelit të nëpunësisë kategoria B (*kategorizimi i pozicioneve sipas nivelit të nëpunësisë parashikohet në pjesën VIII/1, pika 1/a, e VKM nr. 2, datë 8.1.2018*).

Të njëjtin parashikim ndalues për rastet e transferimit të përkohshëm, përmban edhe neni 48, pika 1, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, i cili, shprehet që, “*nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori...*”. Pra, siç shihet, si legjislacioni për nëpunësin civil, ashtu edhe ai për administratën doganore, nuk e lejon transferimin e përkohshëm, në një pozicion pune të kategorisë më të ulët.

Në rrethanat si më sipër, Komisioneri konkludon se, menaxhimi i këtij rasti, nga organi drejtues i institucionit dhe njësia e burimeve njerëzore, nuk është kryer në përputhje

me rregullat e përcaktuara për transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor, por është *fuzionuar* me procesin e zhvillimit të një ecurie disiplinore, pa respektuar kërkesat dhe procedurën që legjislacioni për shërbimin civil dhe ai doganor parashikojnë për një rast të tillë, të cilat do të siguronin mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të nëpunësit civil.

Aktualisht, afati maksimal 6-mujor i transferimit të nëpunësit ***** , që parashikon shkronja “a”, pika 7, e nenit 15, të Kodit Doganor, ka përfunduar dhe në këto kushte, ky punonjës, duhet të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e punës *“Drejtor, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër, Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore”*, në DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, duke respektuar kërkesën e përcaktuar në shkronjën “a”, pika 7, e nenit 15, të ligjit 102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar.
2. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka detyrimin të krijojë kushtet e nevojshme dhe të ndjekë procesin e zbatimit të këtij vendimi.
3. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijëni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në zbatim

të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha